



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1044/12 Prot.

Durrës më, 04/04/2025

VENDIM

Nr. 43 Datë 04/04 2025

PËR

**"PËR SHPALLJEN E APLIKIMEVE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE DHE CILËSISË TË UNIVERSITETIT
"ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 46; të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së, neni 20; të Vendimit të Senatit Akademik nr.20 datë 11.04.2023; të shkresës nr. 961 prot., datë 25.03.2025 të Kryetarit të KPGSC-së; Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 04.04.2025,

VENDOSI:

1. Shpalljen e aplikimeve për anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Kandidatët për anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë vetëkandidohen.
3. Aplikantët personel akademik përfaqësues së njëjësive kryesore duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për Kandidim (bashkëlidhur);
 - b) Kopje të titullit akademik;
 - c) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale (bashkëlidhur);
 - d) Kopje të dokumentit të identifikimit.
4. Aplikantët si përfaqësues të studentëve duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kërkesën për Kandidim, (bashkëlidhur), shoqëruar nga të paktën 30 firma të studentëve që mbështesin kandidaturën;
 - b) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale (bashkëlidhur);
 - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.
5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data **14.04.2025 deri në datën 18.04.2025, ora 9:00 - 14:00**, pranë sekretarisë së Senatit Akademik, zyra 302, Currila.
6. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar, Sekretaria e Senatit Akademik pasi konfirmon të dhënat për stafin akademik që aplikon me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe dokumentacionit, si dhe të dhënat e studentëve që aplikon me Kryesekretarët e Fakulteteve

përkatëse, përcjellë listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatin Akademik.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- ✓ Drejtuesit e Njësive Kryesore
- ✓ Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe dokumentacionit

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

SENATIT AKADEMIK

KËRKESË PËR KANDIDIM STAF AKADEMIK

PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E
STANDARDEVE DHE CILËSISË TË UAMD

Unë i/e nënshkruar/a _____, lindur më ____/____/____, në
_____, të rrethit _____, gjinia _____, staf akademik në
Departamentin _____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time për të
kandiduar si anëtar i Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë të Uamd.

Deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

- Nuk jam dënuar asnjëherë gjatë jetës time, me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale
- Nuk është caktuar ndaj meje asnjë nga masat e sigurimit personal
- Nuk kam qenë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 'Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike';
- Nuk kam qenë shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 45/2015 'Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
- Nuk është dhënë ndaj meje asnjë mase disiplinore e cila është në fuqi;
- Deklaroj nën përgjegjësinë time për mungesën e plagjaturës në punimet për fitimin e titullit akademik.

Kësaj kërkesë i bashkangjitet, kopja e dokumenti të identifikimit, kopja e titullit akademik, vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore.

Për sa deklaroja në këtë kërkesë mbaj përgjegjësi personale për vërtetësinë e tyre.

Aplikuesi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e Senatit Akademik _____,
(firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopjen e titullit akademik;
- c) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- d) Kopje të dokumentit të identifikimit;

FORMULAR VETEDEKLARIMI

Te dhënat e vetëdeklaruesit :

Mbiemri, Emri	
Atësia, Mëmësia	
Datëlindja	
Vendlindja	
Dokumenti i identifikimit (nje kopje bashkëngjitur formularit)	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam :

☐ i/e padënuar ☐ i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRESI I VETEDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta

dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga _____

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

SENATIT AKADEMIK

KËRKESË PËR KANDIDIM STUDENT
PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E
STANDARDEVE DHE CILËSISË TË UAMD

Unë i/e nënshkruar/a _____ lindur
më __/__/__, në _____ student në vitin _____ dega
_____, Fakulteti _____ paraqes kërkesën time
për të qenë anëtar Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe
Cilësisë të Uamd.

Emër, Mbiemër/ Nënshkrimi

U dorëzua sot, më datën _____, në zyrën _____, tek sekretaria e Senatit
Akademik _____, (firma)

Dokumentacioni për kandidim:

- a) Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Vetëdeklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- c) Kopje të dokumentit të identifikimit;